



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republika e Kosovës
Qeveria - Vlada - Qeveria

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

**NJOFTIM SPECIFIK PËR PROKURIM
(SHËRBIMET KONSULENTE)**

Zgjerimi i rruges N2 Milloshevë-Mitrovicë
Sektori: Transport

Përshkrimi i projektit: Shërbimet Konsulente për Rishikim të Dizajnit dhe Mbikëqyrja e Punëve Ndërtimore ne Rrugen M2 Prishtinë – Mitrovicë, me gjatësi 9.78 km.

Mënyra e Financimit: Financimi sipas Istisna's

Nr. I Financimit: ZKS-0002

Kontrata/Oferta Nr.: MESPI/ICB/Services/2023/RFP/01

Republika e Kosovës ka marrë financim nga Fondi Saudit për Zhvillim (FSZH) për koston e Përmirësimit të Projektit të Rrugës kryesore Milloshevë - Mitrovicë M2, dhe synon të aplikojë një pjesë të të ardhurave për pagesat sipas kontratës për Shërbimet e Konsulencës për Projektim, Rishikim dhe mbikëqyrja e punëve ndërtimore të projektit për përmirësimin e rrugës kryesore M2 Milloshevë - Mitrovicë, nga 7+165km në 16+946.5km (me gjatësi 9.78km). Objektivi i detyrës është kryerja e rishikimit të detajuar të projektit, prokurimi i kontraktorit të punëve civile, mbikëqyrja dhe monitorimi i ecurisë fizike, cilësisë dhe gjendjes financiare të punimeve të ndërtimit me qëllim që të sigurohet që punimet të përfundojnë në kohë, duke përbushur specifikimet inxhinierike, standardet sociale, mjedisore dhe rrugore.

Shërbimet pritet që të mbulojnë një periudhë prej njëzet e pesë (25) muaj kalendarik nga data e fillimit. Përfshin, 3 muaj shqyrtimin e dizajnit, përgatitjen e dosjes së tenderit, procedurat e prokurimit dhe vlerësimin e ofertave, 20 muaj periudha e mbikëqyrjes së punimeve dhe 2 muaj periudha e finalizimit të projektit.

Punët ndërtimore përfshijnë Zgjerimin e rrugës ekzistuese, nga rrugë me dy korsi në një rrugë me dy drejtime të ndara me nga dy korsi, secila me 3.75 m gjerësi, me korsi ndihmëse në të të dyja anët me gjerësi 2,0 m dhe objekte tjera anës rrugës. Shpejtësia e projektuar e rrugës është 60-100 km/h.

Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Agjencia Ekzekutuese) përmes Njësisë për Zbatimin e Projektit (NJZP) tani fton konsulentët e kualifikuar që të shprehin interesin e tyre për shërbimet e kërkuara. Konsulentët duhet ofrojnë informacion duke demonstruar

se janë plotësisht të kualifikuar; kanë kualifikimet dhe përvojën përkatëse për të kryer shërbimet konsulentë. Kriteret e përzgjedhjes së konsulentëve do të bazohen si në vijim:

- Strukturën Organizative duke treguar departamentet kryesore që kërkohen për rishikimin e dizajnit, kontrollin e cilësisë dhe shërbimet e mbikëqyrjes.
- Kandidati ka ofruar shërbime në të paktën tre kontrata/projekte të ngjashme në mbikëqyrje të rrugëve, (duke përfshirë një urë të madhe), brënda një gjatësie të rrugës prej të paktën 12 km me një buxhet të paktën 500,000,00 Euro për pesë vitet e fundit nga 2017 deri në 2022 (së paku një kontratë/projekt që është realizuar në Rajonin e Ballkanit). Shërbimet e mbikëqyrjes të kenë të përfshirë rishikimin e projektit detal.
- Kandidati të ketë të paktën 12 persona, Staf të përhershëm që punojnë në fusha që lidhen me kontratën (Mbikëqyrja/Menaxhimi i Punimeve / Dizajni, Rishikimi).
- Qarkullimi mesatar vjetor i kandidatit për tri vitet e fundit (2020, 2021 dhe 2022) duhet të jetë të paktën 5,000,000.00 euro.

Konsulentët mund bashkëpunojnë me firma të tjera, duke formuar konsorciume ose nën-konsulencë në mënyre që të rrisin kualifikimet e tyre. Shprehja e interesit duhet të tregojë qartë llojin e bashkëpunimit së synuar, si konsorcium ose nën-konsulencë me firmën udhëheqëse në Shprehje e Interesit.

Kompanitë konsulente do të përzgjidhen sipas metodës (QCBS), me Përzgjedhjen e Bazuar në Cilësi dhe Kosto, me procedurat e përcaktuara në Udhëzuesit e Fondit Saudit për Zhvillim. Konsulentët mund shprehin interesim Konsulentët mund të shprehin interes në formë bashkëpunimi, të vërtetuar nga një marrëveshje ndërmjet anëtarëve të shoqatës, e cila specifikon qartë llojin e shoqatës, d.m.th., një konsorcium, forma të ndërmjetme shoqërimi ose nënkonsulencë. Kompanitë ndërkombëtare mund të aplikojnë me një preferencë që u jepet kompanive saudite me një partner vendas.

Kompanitë konsulente të interesuara mund të marrin informacion në adresën më poshtë gjatë orarit zyrtar (09:00 - 16:00) nga e Hëna deri të Premtën.

Për: Njësia për Zbatimin e Projektit (NJZP)
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Adresa: Oda Ekonomike e Kosoves, Kati i parë, Zyra.nr.3;
10000 Prishtinë, Kosova
Tel/Fax: +383 38 200 28

E-mail adresa: PMUprocurement@rks-gov.net

Dorëzimi i propozimeve, në anglisht (1 origjinal plus 3 kopje), në një zarf të mbyllur të shënuar qartë “Propozim për Shërbime Konsulente për Rishikimin e Projektimit dhe Mbikëqyrja Ndërtimit të rrugës Prishtinë – Mitrovicë M2, më gjatësi 9.78 km”, duhet të dorëzohet me dorë (fizikisht) ose me postë/korrier në adresën e treguar më poshtë, jo më vonë se data 04 maj 2023 ora 11:00 orë me orën lokale.

Për: Njësia për Zbatimin e Projektit (NJZP)
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Adresa: Oda Ekonomike e Kosoves, Kati i parë, Zyra.nr.3;
10000 Prishtinë, Kosova
Tel/Fax: +383 38 200 28